



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1384/10

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Hidajete Gashi, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses N.P.B.rruga “B.K.” pa nr. P. (NPB), të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V.K., nga P., kundër të paditurit A.R., rruga “S.D.” nr...., P. dhe rruga “I.K.” nr...., P. (adresa e lokalit), për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 3,133.42 euro, në prezencë të përfaqësueses të autorizuar të palës paditëse dhe në mungesë të paditurit në seancën e datës 16.03.2016, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. DETYROHET**, i padituri A.R., rruga “S.D.” nr...., P. dhe rruga “I.K.” nr...., P. (adresa e lokalit), që paditëses N.P.B., rruga “B.K.” pa nr. P. (NPB), në emër të borxhit, për shfrytëzimin me qira të lokalit afarist i cili gjendet në rrugën “I.K.” nr.... në P., për periudhën kohore prej 05.08.2009 e deri me 05.04.2010, t’ia paguaj shumën në lartësi prej 1,223.28 euro, me kamatë si në mjetët e deponuara në bankë për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 16.03.2016 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 50 euro, e te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësja kundër të paditurit pran kësaj gjykate me datë 21.06.2010, ka ushtruar padi, për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 3,133.42 euro për shfrytëzimin me qira të lokalit afarist i cili gjendet në rrugën “I.K.” nr.... në P., për periudhën kohore prej 05.08.2009 e deri me 05.04.2010, shumën në lartësi prej 3,818.31 euro, si dhe kamatën ligjore, së bashku me shpenzimet e procedurës, duke i propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditëses gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, në fillim e njofton gjykatën se i padituri e ka përmbushur një pjesë të borxhit sipas padisë C.nr.1384/10, andaj e bënë precizimin e kërkesëpadisë sa i përketë precizimit të borxhit dhe shumës së borxhit, duke i propozuar gjykatës që të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë tani të precizuar që për shfrytëzimin me qira të lokalit afarist i cili gjendet në rrugën “I.K.” nr.... në P., për periudhën kontestuese prej 05.08.2009 e deri me 05.04.2010, paditëses ti paguaj shumën e përgjithëshme prej 1,223.28 euro, me kamate si në mjetët e deponuara në bankë për një vite pa destinim të caktuar. Me tutje e ka shtuar se raporti juridiko – civil në mes të paditëses dhe të paditurit është duke vazhduar konform nenit 611 të LMD-së.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për taksë për padi dhe për aktgjykim.

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje kontestimore, është mbajtur në mungesë të të paditurit, të ftuar në mënyrë të rregullt në kuptim të dispozitave të nenit 110.1, e lidhur me nenin 423.4 të LPK.

Gjykata në këtë çështje kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plot të gjendjes faktike, sipas padisë ka zhvilluar procedurën, dhe ka administruar këto prova: kontrata mbi qiranë e lokalit nr. ... e datës 24.07.2008, analitika e qiramarrësit nr. i prot. 28/10 e datës 26.01.2016, vërejtja nr. e prot. 03-515-85 e datës 26.01.2016, njoftimi nr. 03-907/281 e datës 02.03.2009, vërejtja nr. 03-940/186 e datës 03.06.2009.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku, e në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të ligjit për procedurën kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko- civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Deri te kjo gjendje faktike, gjykata ka ardhur duke u mbështetur në provat e administruara si më lartë, të cilat i ka pranuar si të besueshme për faktin se nga kontrata për qiranë e lokalit nr. ... e datës 24.07.2008 vërtetohet se në mes të paditëses dhe të paditurit ka pasur raport juridiko – civil, nga vërejtja nr. e prot. 03-515-85 e datës 26.01.2016 dhe vërejtja nr. 03-940/186 e datës 03.06.2009 te paditurit i është bërë e ditur për obligimet që i ka ndaj paditëses po ashtu me njoftimin nr. 03-907/281 të datës 02.03.2009, i padituri është njoftuar për borxhin e papaguar si dhe për mundësinë e shkëputjes së kontratës, ndërsa nga analitika e qiramarrësit nr. prot. 28/10 e datës 26.01.2016, analitika e qiramarrësit nr. i prot. 28/10 e datës 26.01.2016, është vërtetuar se i padituri i ka mbetur borxh paditëses në emër të shfrytëzimit me qira të lokalit, e që sipas kërkesës së paditëses shuma për pagesë është në lartësi prej 1,223.28 euro, dhe atë për periudhën nga 05.08.2009 e deri me 05.04.2010.

Sipas dispozitës së nenit 7 të ligjit për procedurën kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Meqenëse i padituri , nuk ka shprehur gatishmëri dhe nuk e ka pare te arsyeshme qe te jap përgjigje ne padi dhe qe te prezanton ne seancën e shqyrtimit kryesor, më qëllim qe te ketë mundësi qe te prezanton ndonjë provë, qe eventualisht te mund te argumentojë e kundërta e borxhit të pretenduar nga ana e paditëses, gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik – civil ndaj paditëses për borxhin e papaguar, në shumën prej 1,223.28 euro, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 583 të ligjit mbi marrëdhëniet të detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se Qiramarrësi ka për detyrë ta paguajë qiranë në

afatet e caktuara me kontratë ose me ligj e në mungesë të kontratës dhe të ligjit, ashtu sikundër praktikohet në vendin ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit.

Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe ose në vendin e dorëzimit të sendit nuk praktikohet ndryshe, qiraja paguhet për çdo gjashtëmuor kur sendi është dhënë me qira për një ose për disa vjet e në qoftë se është dhënë për një kohë më të shkurtër, atëherë pasi të ketë kaluar kjo kohë.

Vendimin që pala e paditur të obligohet në pagesën e kamatës ligjore gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 277, par.1, të LMD-së, me të cilën dispozitë shprehimisht thuhet “debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton përpos kryegjësë edhe kamatën sipas shkallës e cila në vendin e përmbushjes paguan depozitimet e kursimit më të parë”.

Vendimin për shpenzimet procedurale gjykata e vendosi në mbështetje të dispozitës se nenit 449, dhe 452.1, të LPK-së, ku paditësi si palë gjyqfituese gjykata ia njohi shpenzimet procedurale të kërkuara dhe atë sa i përket taksës gjyqësore për padinë e ushtruar shumë prej 25 euro, dhe taksës për aktgjykim në shumë 25 euro, **GJITHSEJTË 50 euro.**

Andaj gjykata duke ju referuar të cekurave më lart vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, C.nr. 1384/10 me datë 16.03.2016**

**G j y q t a r j a  
Hidajete Gashi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa,  
ne afat prej 15 dite, pas marrjes se të njëjtit,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes së kësaj  
Gjykate.